

VENDIM
Nr.466, datë 29.06.2006

PËR DHËNIE LICENCE
PËR RADIO VENDORE PRIVATE
“LOGOS”

SUBJEKTIT FIZIK: GEORGE STURM

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, rregullores “Për licencimin e operatorëve privatë për transmetim rtv analogjik tokësor në nivel vendor” të miratuar me vendimin nr. 355, pika 1, datë 29.08.2005 të KKRT-së, të vendimit nr.444, datë 21.03.2006 të KKRT-së “Për organizimin e konkurrimit të kandidaturave për operatorë privatë vendorë radio e televizivë”, si dhe rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë” të miratuar me vendimin nr. 375, datë 30.11.2005 të KKRT-së, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

V E N D O S I:

1. T’i japë subjektit fizik, z. George Sturm licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator vendor radio FM private, në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore me modulim në frekuencë për një periudhë prej 3 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal qytetin e Pogradecit.
2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj